

INTERVISTË ME SELATIN NOVOSELLËN

Prishtinë | Data: 16 shkurt, 2022

Kohëzgjatja: 102 minuta

Të pranishëm:

1. Selatin Novosella (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Keni me u prezantu, datën e lindjes, vendin, diçka për familjen e juaj?

Selatin Novosella: Po, kam lindur në Vushtrri me 1 korrik të vitit 1945. Baba jem ishte Ismajli, si Maxhun, domethonë i fshatit Maxhunaj. Kurse nana Naile ishte e fshatit, domethonë e ni fshati të Llapit, Naile Shala. Unë kom pasë, se nuk i kom, domethonë pesë vllazni e tri motra. Tre vllazën në ndërkohë më kanë vdekë, tash jemi tri vllazën, tri motra. Vitin e parë, fillore, do të thotë e kom kry në Vushtrri, kurse pastaj vitin 1953 kemi kalu nga Vushtrria në Prishtinë.

Kuptohet kom kry shkollën fillore, gjysën e landëve i kemi pasë serbisht, tetë-vjeçare kuptohet. Kemi pasë serbisht, landa si landë serbisht. E kemi pasë punëdore serbisht, fiskulltura serbisht, muzika serbisht. Arsimitaren e frengjishtës na jepke serbisht. Dikund gjysa e landëve kanë qenë serbisht. Na të tjetër faktikisht nuk dishim kurgjo serbisht, qaq sa mujshim shkollimin. Vitin 1961 jom regjistru në Shkollën Normale, atëherë ishte “Milladin Popoviq” e për fatin tone tash është “Eqrem Çabej”. Kurse ku kom kry shkollën fillore ka qenë, “Vuk Karaxhiq”, e për fatin tonë sot osht’ “Elena Gjika”, domethonë edhe emrat flasin për...

Do të thotë, fëminija ime ka qenë fëmini si e të gjithë mocanikëve të mi, me varfëri ekstreme, me probleme të theksime ekonomike, pa çanta. Kena pasë naj fletore i thojshim të holla me do tela të kapun anash. Shpeshherë merrshim libra prej njani-tjetrit. Unë kom qenë në [Shkollë] Normale, kurse nuk kom pasë këpucë, as s’kom pasë patika, puma që i thojnë tash, kom pasë opangë të llastikut. Ishte koha e tillë, domethonë ishte varfëri ekstreme.

Për mu kthesë jetësore ka qenë Shkolla Normale, se atëherë nuk kishte fakultete të Prishtinës, por shkolla e cila kishte kuadrin ma të mirë. Jo veç në Prishtinë, por në Kosovë ishte pikërisht Shkolla Normale. Përgaditëshe për mësues edhe aty ishte ni përparësi që në momentin që ti kryje shkollën ti meniherë filloje të punoje. Tash është problem me punu meniherë, e atë ditë [që ke diplomu] edhe më shumë. Aty na kanë dhanë mësim profesorët ma të mirë të kohës, në mesin e tyre [Pajazit Nushi](#), Sali Nushi, Beqir Kastrati, Shefqet Veliu, e plot të tjerë.

Posaçërisht na si të ri që ishim i dojshim shumë, gati, gati i adhurojshim dy profesorë të cilët e kishin krye Normalen në Elbasan. Ishte ni njohuri ajo shumë e cekët, e mangët [në atë kohë], se atë Normale të Elbasanit e kishte themelue Luigj Gurakuqi, kishte atë simbolikën e vet. Këta na jepshin në Normale mësim. Aty kom fillu vjerrshat e para që na vishin tinza, që as vet nuk e di kah na vishin, jo për shembull poezitë, domethonë të “Shqipnisë së Robnume” të Pashko Vasës ose të “Kosovës së Lirë” të Pirro Floqi ose “Gjarpënijtë e Gjakut” e Adem Demaçit, për të cilin flas më gjanësisht ma vonë. Na vinte me shumë vështirësi edhe “Lahuta e Malësisë” e Gjergj Fishtës. Ato i përshkruan, i jepshim njoni-tjetrit.

Do të thotë, ato kanë qenë për herë të parë kur kom fillu ta nij vetën, do të thotë të jesh shqiptarë, të jesh shqiptarë. Kom kuptu me shumë pak informacione se Kosova ka qenë pjesë e Shqipërisë, dikur 1912-ën është nda. Në 1945-tën përsëri është nda dhe ne ishim në robëri. Sikur që e ceka në fillore, tash në Normalen e Prishtinës ndodh që pregaditeshim për mësues, plus minus rreth gjysa e landëve përsëri msoheshin në serbisht. Paramendo çfarë ironie! Ne pregaditeshim për mësues, kurse ne landtë i msojshim serbisht. Kjo ishte në rend të parë mungesa e profesorëve, mungesa e kuadrit, po një numër i profesorëve të ditur e të aftë nuk i linin me punu.

E tash, në Normale ka qenë ni grup letrar që quhej “Migjeni”. E udhëheqke ni djallë shumë i mirë, ni poet i njohur Zeqir Gërvalla, i cili për fat është ende gjallë në Amerikë. Për çdo javë ose herë pas here majshim orë letrare aty. Ni ditë, ky Zeqir Gërvalla që kishim marrë vesh që shoqnohet me Adem Demaçin, po na thotë në orë letrare, “Kur kryhet ora letrare ka me folë edhe Adem Demaçi”. Ai kish dalë pak kohë prej burgut të parë 1963-tën. “Kur flet Adem Demaçi, ju shpërndahuni nëpër sallë”. Normalja ka pasë ni amfiteatër diku rreth 250 nxanës, nuk ka pasë shkollë me amfiteatër ma të mirë se atëherë. “Kur flet Adem Demaçi, ju duartrokitni, veç duartrokitni”.

E mori Adem Demaçi fjalën, para se të fliste, ne që ishim shpërnda nja pesë-gjashtë shokë duartrokitëm edhe duartrokitjes tonë iu bashkangjitën edhe duartrokitjet tjera. Tash, kur e mori Adem Demaçi fjalën tha, “Kom ni problem, a me folë a jo? Unë i ndëgjova poezitë e juve, tregimet e juve shumëçka më pëlqynë. Patëm edhe ndonjë mendim, po ju duartrokitët shumë. Tash nëse nuk ju pëlqejnë fjalët e mija bon vaki që pendoheni pse keni duartrokitë kot. U dashtë me më lonë me folë, se bon vaki edhe e prishi krejt”, nga ajo modestia e tij e natyrshme, “po tash nuk di si t’ia boj”. Kjo modestia e tij na motivoi edhe ma shumë edhe duartrokitjet tona u shndërrunë në ovacione, u çu krejt salla në kamë.

Në nifarë mënyre mund të thuhet ky ishte takimi i parë i jemi me Adem Demaçin. Ndonëse shpijat si shpija na i kishim në të njejtën rrugë te “Dodona”. Tash i kemi, kuptohet me familjen e Ademit, se na zakonisht i kemi thonë baca Adem. Ky ishte takimi i parë me të. Unë deri tash kom shkru diku rreth 12-13 libra për Adem Demaçin. Kurse këto mrapa që i kemi {i referohet librave në dhomë}, ky është ni projekt 14 vëllime ku është e përgatitun jeta edhe vepra e Adem Demaçit, për të cilën nuk guxoj me folë se duhet me folë ni muj. Edhe kështu do të thotë...

Anita Susuri: Po çfarë fjalimi ka qenë ai i Adem Demaçit? Për çka ka folë?

Selatin Novosella: Jo, ai s'ka qenë kurrfarë fjalimi, ka qenë i natyrës, shkrimit e nxansave, disa mendime që na s'i kuptojshim sa duhet. "Ju do të boheni nxanës të mirë, të edukum, të sjellshëm. Duhet të boheni mësues të mirë. Kosova ka nevojë shumë për mësues, ka nevojë që t'i edukoni në frymën kombëtare. Kosova ka nevojë për shumëçka, për gjithçka. Por, ma së shumti ka nevojë për mësues që do të shpërndaheni në tetë hapësirat e Kosovës. Prandaj, ju jeni shpresa e ardhshme e Kosovës, për çka ne kemi shumë nevojë. Prandaj, ju du shumë, ju çmoj shumë".

E tash prej [Shkollës] Normales deri në Prishtinë mund të jetë një 20 minuta, domethonë tre-katër kilometra, kuptohet na erdhëm në kamë me bacën Adem. Ishte vonë, se orët letrare maheshin në mramje, masi u kryjke mësimi. E pata shoqëru deri te shpija edhe i kishim shpijat ksajde. Tanë kohën ai t'u sugjeru që të merresha me shkrime, me shkrime, "Msoni, lexoni, boni referatat, hartimet, por mos harroni të shkruani", ky ishte mesazhi i tij, "dhe të shkruani atëherë kur ju vjen frymëzimi, krejt çka ju vjen frymëzimi qitni në letër. Lene anash dy-tre-pesë muj mos e prekni. Kur keni me ju kthy atij shkrimi që keni bo, të parën punë keni me thanë, 'Shumë mirë kom bo', se s'mun e shkrinë ma atë", se ai ish shkrimtar.

Qe këto, "Jeta e tretë", që po e shohim na të gjitha janë tregime të Adem Demaçit dhe, "Gjarprinjtë e Gjakut", që i ka botue prej vitit '53 deri në '58 kur është burgosë herën e parë. Këto janë shkrimet e para të Adem Demaçit. Prandaj, Adem Demaçi ishte njeri që ish, që kish përvojë, kish përvojë shumë. Domethonë, ka qenë ni takim që për mu mund të thuhet gati moment kthesë në jetën time. Në ndërkohë fillunë në Normale m'u shkrujtë disa parulla. Në të majtë t'u shku te Normalja është ni kodër bukur e lartë me tulla, me ndihmën e arsimtarëve kuptohet, i ka shkrujtë, "Rrnoftë 29 Nandori!" Kuptohet, Dita e Jugosllavisë.

Dikush natën, ndonji belaxhi, ndonjë djalë i mirë a çikë e mirë sigurisht, po s'i kom njoftë ata kanë shku nandëshin e kanë bo tetë. I ka qit' do tulla, u vrejshin që janë qit', mandej e kishin pasë ngjyrosë me qyreq, me ngjyrë të bardhë. Po që nga distanca, diku nga ni metër tash kish dalë shumë shumë simbolikisht. Jo rroftë, po rrnoftë, jo "Rrnoftë 29 Nandori", por "Rrnoftë 28 Nandori". Ishte lajm atëherë. Sot nuk është kurgjo hiç, por atëherë ishte lajm. Se të rrnon 28 Nandori është të rrnon Ismajl Qemaili, të rrnon Isa Boletini, të rrnon Shqipnia, të rrnon flamuri. Prandaj, ne si fëmi faktikisht u frymëzum prej ktyne, prej kësaj parole.

Në ndërkohë, nuk e di a ka qenë ngjyrë e bardhë në hodhje të drunit apo ka qenë gëlçere, veç e di që e kom pa. T'u kthye për në Taukbahçe, ky udhërkyqi që shkohet për Gërm, cep më cep të rrugës e kish shkru dikush parollë me shkronja të mdha, "Kosmeti i takon Shqipnisë". Shumë e fortë. Atë ditë Fadil Hoxha ishte kryetar i kuvendit atëherë, erdhi në Normale. Dhe çdo klasë e kemi pasë autoparlantini mbi derë. Ndonjë lajm, ndonjë informatë, ndonjë ligjeratë prej drejtorit çka ka pasë... faktikisht flitej aty,

kuptohet arsimtartë edhe kujdestartë na kërkoshin qetësi e ndëgjoshim çka po flasin, ka qenë kohë e tillë domethonë.

Ne murëm vesh që ka ardhë Fadil Hoxha aty edhe në heshtje p’e dëgjojmë çka po thotë. Thotë, “Armiku”, jo, “Uji flen, armiku s’flen. Armiku ka depërtue në mesin tonë, në radhët tona dhe ka gjetë pikën ma të dobët. Mësuesit e ardhshëm do të ndikojnë armiqësisht kundër shokut Tito, kundër Jugosllavisë, kundër Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe kanë shkruar “Kosmeti i takon Shqipnisë”. Ata irredentista, ata e dojnë Shqipninë, ata e dojnë Partinë Komuniste të Shqipnisë, ata e dojnë Enver Hoxhën. E na duhet të luftojmë, se ata janë armiq të rrezikshëm, se kanë prek pikën ku s’preket”.

Për të vërtetën, ne nuk e dishim kush e ka shkruar. Kom marrë vesh shumë ma vonë, shumë ma vonë. Kur i kom shkruar 35 libra për lëvizjen atëdhetare ilegale në Kosovë, kom bisedu me ni djalë që ka qenë shok i ngushtë i Sharr Hoxhës, i djalit të madh të Fadil Hoxhës. Disa shokë më kanë thanë, “Pse po e thue?” E them, duhet të thuhet e vërteta, gjithnjë e vërteta. Nji djalë, ishte Foto Nesha, Foto Nesha ni fotograf i njohur dhe ka qenë Bujari, bile Disdali e kanë pasë mbiemrin si turqisht Disdal. Edhe kur p’e sheh që e kom shkruar une librin, po e ceku, “S’e di kush e ka shkruar parollën ‘Kosmeti i takon Shqipnisë’”.

Kishte ni zyre dikund tjetër, ai Bujari ni djalë me shumë edukatë... ata kishin qenë Normalista, gjimnazista, në këtë gjimnaz. E përpara të regjistroheshe në gjimnazin e Prishtinës, atëherë, “Ivo Lolla Ribar”, tash “Sami Frashëri”, ka qenë lajm, lajm. Se kryesisht fëmija e udhëheqësve kanë qenë të vendosun. E tash vjen ky Bujar Disdali thotë, “A din kush e ka shkruar parollën ‘Kosmeti i takon Shqipnisë’?” “Jo”, “E ka shkruar”, tha, “Sharr Hoxha, djali i Fadil Hoxhës”. E pa imagjinueshme, e pa imagjinueshme! Djali i Fadil Hoxhës të shkruan, “Kosmeti i takon Shqipnisë”, fjalë e madhe. Unë Sharrin s’e njifsha, nga distanca por s’e kisha shok. Djali i udhëheqësit edhe ishim në tjera shkolla.

Çka po du me thonë me këtë... kurse Vahidja, Vahidja, gruaja e Fadil Hoxhës ka qenë domethonë profesoreshë e njohur e historisë. Që të bën me dije, ta quj ni lloj analize, Sharr Hoxha e ka msu prej dikujt që “Kosmeti i takon Shqipnisë”. Prej kujt? Prej babës, se baba ka ditë, ka ditë shumë mirë që Kosova është pjesë e Shqipnisë. Pse e përmendi këtë moment? Unë jam i bindur se historiografisë, pjesë e kësaj pune që edhe këta që po e boni ju është ni pjesë.

Bile, bile, ma ka thanë Zekirja Cana, ni historian i njoftun... unë i kisha përdorë disa, përdorë disa fusnota në fund të librave m’ka thanë filan fisteku. Në aspektin metodologjik, se unë nuk jam historian, jam profesor i gjuhës, po ai ishte historian po e marr si redaktor. “A mund t’i citoj në fusnotë mendimet e këtij e këtij për ni ngjarje?” Thotë, “Po, nëse thotë deklarata është autentike, është e saktë duhet të ceket në fusnotë, është më e saktë se çdo dokument tjetër. Dokumenti mund të falsifikohet kush e ka shkruar. Nesër kur citohet ai vendim, nuk citohet autori që e ka thanë po citohet libri”.

Unë i citoj këto mendime. Çka do të thotë? Fillimet e veprimtarisë time atdhetare gjegjësisht edhe politike, po faktikisht politike po atdhetare në esencë ka qenë Normalja. Kthesë në jetën time ka qenë Normalja. Unë ni ditë, ni natë në të vërtetë se pasdite mbahej mësimi kur po vi në shpi po e shoh nanën Nailen, tash të ndjerën, me shoqen e vllaut Sabriut po enën nëpër oborr të shqetësime, “Çka po ndodhë?” Tha, “Sabria”, tha, “është idhnu me krejt”. Sabriu vllau im pronari i “Nana Nales” tash. Thashë, “Pse?” Tha, “U shtri”, tha, “në dhomë e ka qit’ edhe grunë prej dhomës”, Safetin. Ata sa ishin martu, s’kish ni vjet. “Edhe ma s’po na len me hy kërkond në dhomë”, ishin bo marak.

Cokata une në derë, s’e çelë. Cokata, s’e çelë. “Sabri, o Selatini”, e çeli. E kish pasë mshelë derën me nifarë mekanizmi. Kur çka me pa, krejt dhoma pëlhurë të mëndafshtë të mirë, të kuqe, të verdhë edhe të zezë. Ai kish marrë porosi me kep flamuj. “A po më ndihmon?” Thashë, “Po”. Kom qenë vizatues i mirë, kom qenë nxanës i profesorit të njohur Engjëll Berishës. Tha, “Me ma vizitu shqiponjën se m’ka ardhë ni letër vllau jem”, ai s’ish konë ardhë hiç, po në çfarë kushte është veprue. Këto sene që po i thom une për juve s’janë, se jeni shumë të reja. Por edhe për ni numër shumë të madh, për fëmijtë e mi nuk i besojnë, se janë të pabesueshme kur vllau vllaut nuk guxon m’i kallxue. Kur djali nanës nuk guxon m’i kallxue. Kur burri grusë nuk guxon m’i kallxue.

Nuk ish konë e vërtetë hiç këto që ma tha, “Qe”, tha, “e kom marrë qit’ letër’. E po thotë, “Dil Selatin...” [ai] ka qenë rrobaqepës, punonte edhe në lokal, por ka pasë ni maqinë të vogël punonte edhe në shpi mas kohës. “Dil filan dite, filan kohe, filan vendi, minuti. Merre qit’ material qepi njiqind flamuj të Shqipnisë. Pshtjelli apet lej në qat’ vend. Mos i kallxo kërkuj, mos e din kërkush dhe nëse s’e kryen këtë punë na kena me të likuidu ty me familje”. Unë u trishtova. Ajo s’ish konë e vërtetë hiç, por me arsyetue domethonë. E qashtu ni flamur na u prish i qepëm 99. Ata 99 flamuj pastaj janë shpërnda në krejt Kosovën, kuptohet t’u përfshi edhe Prishtinë e Prizren. Dhe ajo kish qenë veprimtari e organizatës Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, të cilën Adem Demaçi e kishte themelue e s’e kom ditë, vonë e kom marrë vesh këto.

Në shtator të vitit 1963 me Zeqir Gërvalla, me Fazli Grajçevci që do të jetë dëshmor ma vonë, e me shumë të tjerë. Tash, kjo lëvizje, kjo organizatë i ka pasë shtatë komitete. Se NDSH-ja ka pasë komitete, s’kanë pasë degë. Tash këto partitë kanë degë, atëherë kanë pasë komitetet. Domethonë LRBSH-ja ka pasë Komitetin e Prishtinës, të Mitrovicës, të Pejës, të Gjakovës, të Gjilanit, të Shkupit dhe të Stambollit. Për fatin tonë, kryetari që e ka udhëheq Komitetin e Stambollit, domethonë Njazi Saragjogllu osht’ gjallë. Ai në Stamboll është gjallë.

E tash, u kryen disa aktivitete. Çfarë aktivitete? Për parolla me ngritë flamuj, kjo ishte domethonë. Amo në ndërkohë Adem Demaçi e kish shkru programin 54 faqe të cilin e kom marrë në arkiv, kuptohet, për fat është rujtë. Neni parë që është esenca e kësaj organizate thotë, “Lëvizja jonë”, pra organizata, “ka për qëllim çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të okupime prej Jugosllavisë dhe sigurimi i të drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje dhe si qëllim të fundit ka bashkimin e ktyne viseve me nanën Shqipni”. Ai dokument osht’, unë e kom botue me dhjetëra herë.

Serbia e vlerëson një prej organizatave më të rrezikshme të asaj kohe. Masë në aktiviteti jo shumë të gjatë, fatkeqësisht, vjen burgosja. Numrin e saktë s'e ka marrë vesh kërkuar hiç, po Adem Demaçi e ka thënë herë pas here diku rreth 300 e sa vetë jena burgosë. Në ato hetime çfarë kanë qenë? Vet fakti që Fazli Grajçevci mbytet në tortura, se vrasja, pushkatimi, varja nuk është tmerr ma i madh. Tmerr ma i madh është kur njeriu vdes prej torturave. Ju jeni shumë të reja po du edhe të ju ru, të ju kursej çfarë torture janë përdorë aty. E kur njëni vdes në tortura, munësh me marrë me mend që të gjithë tjerët janë torturu ashtu. Pas burgosjes së Adem Demaçit dhe shokëve, atëherë u burgos edhe vllau im, Sabriu. Na metëm jashtë...

Anita Susuri: Cili vit ka qenë? Veç ta kemi...

Selatin Novosella: 8 qershor, 1964.

Anita Susuri: '64.

Selatin Novosella: Dhe tash na që metëm të rinjtë edhe të reja, kuptohet, përsëri vazhdimë ngritjen e flamurëve dhe shkrimin e parollave. Tash kishim për qëllim, përveç tjerash, me bo me dije edhe pse burgosja e Adem Demaçit dhe shoktë e tij, na do të vazhdojmë hala në mënyrën tonë. Edhe kur i dajmë ato, patëm detyrat, mu më ra hise, se na vetke ai shoki jonë Ilmi Rakovica, "Ku po don me shkru parolla dhe me ngritë flamurin?" Unë lypa në Vushtrri. Më kish mbetë ajo kujtesa, atëherë i kisha diku kah 18 vjeç, 17-18 vjeç. Edhe m'u doke sikur po shkoj në atë vendin e lindjes e kom ma kollaj, se ato krejt boheshin natën, kuptohet, në ora 10:00. 10:00 deri në 10:05 që e krym mirë, që jo nuk guxojke ma shumë, se ish qashtu.

Unë shkova me ni shok temin, Ibrahim Gashin, deri në Fushë Kosovë me autobus. Prej Fushë Kosovës deri në Vushtrri me tren, kurse prej stacionit të trenit shkum në kamë. Ka qenë kalaja e qytetit, aty hypeshe në ambient të hapur se ishte nxet. E pamë, e kqyrëm ni film se u dashke për me nejt dikund që deri në ora 10:00 s'kishe ku me nejt. Me u enë nëpër rrugë, qysh? Unë kisha shumë, që thojnë në Gjakovë, kisha shumë ilake atje, po nuk guxojsha me u paraqitë te ta, "Pse ke ardhë? Qysh?" E kur u kry filmi, na kena dalë, e kemi kqyrë që osht' ora 10:00 jemi nisë.

Ky shoku jem e ngriti flamurin bash ku ishte ni dritë në maje të shtyllës atje. Ka qenë tip sportiv. Pse ngjitet njeri 10-15 metra, si duket i shtrëngojke dur të i lshojke kam të, i shtrëngojke kam të i lshojke dur të. U ngjit sa hora. E ngjiti flamurin e ngjiti atje. U duhej me u ngjit me patenta, e dur të me i ly me hudër që kur te nxojnë UDB-ja, policia, qentë mos me mujtë me ia ni erën, gjurmët se i vjen era e hudrës. U konë kohë e tillë domethonë. E tash unë po i jep shenjë prej ni kandi te kthesa, bash në lagjen time ku isha lindë, shtatë vjet kur kisha dalë prej atyhit, kisha si fëmi emocionet. Tashti po i dho shenjë që ndërpreje se s'kem kohë, kishim me i shkru parollat hala. Se përparësi kishte flamuri, parollat nëse arrijmë.

E çka është e vërteta, e kishte zgat flamurin po e puth atje në kryet. Unë po i boj me shenjë që s'ò rend puthje, s'kemi kohë, ik! Ai ka kujtoftë që ka shenjë rreziku, u lshu. Kur u lshu me kamë, me durë, me krejt ato cpirrat e drunjëve ju mush trupi, domethonë. Fëmi qysh ishim. Unë e kisha tekstin për tri parolla me i shkru, se më shkojke vizatimi. Parollat u dufke me konë sa ma të shkurta edhe me përcjellë ni mesazh. Parolla e parë dihet, “Duam liri!” Kaq s'e kemi zgatë aty muhabetin. Parolla e dytë, “Rrnoftë Shqipnia”, se ata që na kanë mësue e kanë ditë që pa rrnu Shqipnia, Kosova nuk rrnon, pa Shqipni s'ka kurgjo hiç kurrë. Tash s'ka, tash mos me kanë Shqipnia, Kosovë nuk ka. Krejt politikë.

Parolla e tretë që m'ka mbetë zhig me shkru shumë kur e kom tregu këtë rast para nja 10-15 vjete në ni sallë, në datë të përrimit të ni libri për Rexhep Malën, unë s'e kom ditë që kish qenë djali i Enver Hoxhës në atë sallë edhe po e tregoj këtë fragment jetësor, nuk e di qysh ra. Po thom, “Parolla e tretë m'ka metë shumë marak që s'e kom shkru, e kom nisë me shkru m'ka mbetë në gjystë se ka qenë ma e gatë, ‘Rrnoftë Enver Hoxha!’ E kom shkru veç rrnoftë, po Enver Hoxha s'kom mujtë me shkru se ky shoku m'dha shenjë që ik”. E ka pa dikond me sakicë, natën me sakicë, pa konë belaxhi a del? Na prej tutës e kena lonë në gjystë.

E tashti njani prej shokve të mi, [Hydajet Hyseni](#) po thotë, “A të ka metë atëherë zhig me shku ‘Rrnoftë Enver Hoxha’? Po dil shkruje qitash”, “Qitash s'pe shkruj se s'osht' koha”, domethonë kështu. Mandej u burgosa edhe unë, të them të drejtën majta pak kohë burg, po kur dola prej burgut më përjashtunë prej shkollës, vllau u dënu në ndërkohë, Sabriu nëntë vjet. Po u bo kërdua, u burgosën me qindra vet. Krejt shoktë e shoqet e mija metën shpijave, çikat i kishin familjet nëpër katune, shkunë me punu punë kopshti, punë arash. Unë nisa me i rujtë loptë e shpisë, u bona çoban. Ishte ni ndjenjë e trishtueshme domethonë.

Anita Susuri: E qajo burgosja, qysh ka ndodhë?

Selatin Novosella: Qysh?

Anita Susuri: Burgosja si ka ndodhë?

Selatin Novosella: UDB-a më ka vetë, “A po don me pa Sabriun s'e ke pa në burg?” Thashë, “Sigurisht”. Kur më kanë çu në burg m'thanë, “S'të kena thirrë me pa vllaun, po të kemi thirrë për do punë që i ke bo tash”, kaq, u kry. Se na hala kujtojmë që UDB-a si të sheh të vret, UDB-a janë njerëzit ma përfid të mundshëm qysh burgosen, qysh flasin, qysh sillen jashtë. Ata janë njerëzit ma të edukum që i sheh dikush. Shërbimi Sekret qata e kanë, ata s'kanë agresivitet. Agresivitetin e kanë në qeli, në burg edhe në hetime.

Anita Susuri: Në cilin burg ju kanë çu fillimisht?

Selatin Novosella: Të Prishtinës. Edhe biseda e parë, se kur e kanë burgosë vllaun, Sabriun, na kishim ni fotografi të Skenderbeut, pikturë në mur. Nuk e vlen historinë me kallxue qysh e kishim siguru atë fotografi. Bile kur e morën, ia hoqën kornizën e thynë atë pikturën dy fish, katër fish e morën si *corpus delicti* domethonë si dëshmi penale. E tash ni prej tyne shkijeve¹ UDB-ash, hetues, thotë, “Fol krejt çka din për Skënderbeun”. Çka disha? Kurgjo. Hiç s’disha kurgjo. Kuptohet pesë a gjashtë në kamë t’u piskat secili në mënyrën e vet. Thotë, “Krejt çka din për Skënderbeun me folë”, thashë, “Nuk di kurgjo”, “Qysh”, tha, “nuk din?” Çështje e vërteta fotografia ime nuk ish ni metër me ni, e rriti shkau. Tha, “Fotografinë në muri ni metër me ni të Skënderbeut e nuk din kurgjo hiç. Fol”.

Unë krejt çka kisha ni, kisha ni prej profesorit të letërsisë Ditar Qamilit, i Prespës të Maqedonisë bile e flitke ni gjuhë, sikur që dinë ata me folë mirë. Na kish kallxu ni legjendë se si Vojsavës, nanës së Skënderbeut iu kish ba ni, iu kish paraqit andërr që ka me lindë ni fëmi me yll në ballë, si legjendë. Edhe që Skënderbeu gjatë kohës të luftës Perandorisë Otomane, kur ka fillu gjatë luftës e rrethimit të Krujës, si legjendë, ka fluturu me kali, hiç s’ka ecë ka fluturu prej ni shpati në ni shpat. Në Krujë e kom pa doket sikur me konë patkoj, ata sigurisht prej shiut, prej bore... e kanë formën e patkoit edhe emrin e kanë, “Gjurmët e kalit të Skënderbeut”. Domethonë disha prralla, nuk disha kurgjo hiç. Po diçka disha. Ai po më thotë, serbishten s’e dini ju dyja kuptohet? [I drejtohet intervistuesëve].

Anita Susuri: Po, e dijmë.

Selatin Novosella: E dini? “*Gde se rodio*” [srb.: Ku u lind Skenderbeu?] tha, “Skenderbeg?” unë me gjysë zani i ngrati fëmi, krejt në kamë ata, unë në ni karrige i ungjun aty në qosh thashë, “*Rodio se u Albaniju*” [srb.: U lind në Shqipëri]. “*A zašto se borio Skenderbeg?*” [srb.: Për cka ka luftuar Skenderbeu?] “Skenderbeg...” qysh e kom thanë gjuhën e sakatosur s’e kom ditë mirë (buzëqesh) veç kom thonë, “*Borio se za oslobođenje Albanije*” [srb.: Ka luftuar për çlirimin e Shqipërisë]. Çka po don ti ma shumë me ditë? Ai s’ish kurgjo faktike. Me qasi force m’ka mshu shuplakë, ishte shuplaka e parë që isha i ulun, ai si plep i madh. Me qasi force m’ka mshu që merre me mend le që jom rrxu unë, u rrxu karrika ku isha po edhe ai u rrxu përmi mu. Domethonë, u bo kijameti. Ata menojshtin që po boj hajgare me ta, a qashtu ish, unë bojsha hajgare se isha fëmi (buzëqesh).

Ky ishte takimi i parë me UDB-ën. Mandej hetimet kryesisht i ka kry ni shka që ka folë shqip. Se hetuesit, UDB-ashit shqiptarë janë konë të pakrahasueshëm ma të kqi se shkijet. A osht’ lehtë me kuptu? S’osht’ lehtë, as ju as lexuesi nesër s’mund ta kuptoj. Pse? Serbia shkije ka pasë në Serbi sa të dush, ka pasë edhe në Kosovë sa të dush, i ka bo shqiptartë e kta jonë konë ma të kqi se shkijet. Torturat që i kanë përdorë shqiptartë gjatë hetimet, fyret që i kanë bo, poshtërimet që i kanë bo... kurrë shkive s’ju bishin në mend.

Unë katër herë kam qenë i burgosun. Vitin 1964, 1965 kur jam dënu pesë vjet për demonstrata, vitin 1975 kur jom dënu me Adem Demaçin, Rexhep Malën, vitin 1981 mu ni shuplakë ma ka mshu ni hetues

¹ *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarët e përdorin për serbët.

shka, krejt shqiptarë. Kto do të dihen, kto do të nihen, kto duhet të kuptohen. Për shqiptarë UDB-ashët, policët, prokurorët, gjyqtarët, udhëheqësit e Partisë Komuniste, Kosova jo që s'do të ishte Republikë, jo që nuk do të ishte *Pokrajina Kosova* [srb.: Krahina e Kosovës], do të ishte Kosmet, Serbi. Mos me konë Adem Demaçi e shoktë e tij, mos me konë UÇK-ja e Adem Jasharit, sot Kosova ish Serbi. Qasi shqiptarë ka pasë që e kanë dashtë Serbinë, që e kanë dashtë Jugosllavinë, e kanë dashtë Titon. Kjo është e vërtetë, është e dhimbshme duhet të thuhet e vërteta historike. Domethonë, unë e majta ni kohë aty mas lirimit nga burgu që thashë ma ndërprejten shkollimin. Po tash...

Anita Susuri: Sa keni qenë aty?

Selatin Novosella: Urdhno?

Anita Susuri: Sa...

Selatin Novosella: Pak, pak. Ka 30 ditë.

Anita Susuri: S'keni pasë vizita kështu?

Selatin Novosella: Jo, jo, çfarë vizite. E tash mas lirimit nga burgu, mas dy vite domethonë '66-ën me 1 korrik bash në ditëlindjen time, unë isha në burg te Sabriu në Goli Otok. Sabriu e mbante burgun nantë-vjeçarë, isha shku me nanën, me shoqën e Sabriut edhe me Ilirin, djalin e Sabriut. Bile osht' ni moment, ai Iliri s'e njifke babën e vet kuptohet e po më thotë, se fëmija më thojshin bac edhe tash më thojnë bac krejt, "Bac, qysh duket babushi? Se unë s'e njoh". "Tash unë çka me i shpjegue", veç po thom, "babushi është më i bukur prej krejtve", aty dilshin plot të burgosun, thashë, "është pak i zi", a Sabriu nuk është pak i zi është bukur i... kështu a din. Po poget dielli i fortë i atjehit e kish pasë boe ngjyrë çokollate, ai tanë kohën t'u nejt jashtë. I kish lshu musteqet deri kha {prek faqet me duar}. Po i them është kështu është kështu është kështu.

Është ni moment, domethonë, ni moment i pakomentueshëm, i pashpjegueshëm, i trishtueshëm. Tash kur ka dalë Sabriu me shokë të vet, kanë dalë edhe ni Avdyl Lahu shok që ish burgosë me të, Fadil Cuka e do të Prizrenit, Haxhi Zybaç e ku di unë i Bukoshit, plot djem të Prizrenit. Tash ka dalë ni prej atyne shokëve i pari, e ky si e ka pa edhe i zi edhe me musteqe ka nga e ka kap për qafe, e trishtueshme domethonë. Ky shoku i Sabriut e murr vesh që ka gabu djali. E thotë, "Ilir, unë jom shoku i babushit, unë jom shoku i babushit nuk jom babushi". E vështirë, e tmerrshme, e tmerrshme!

Pjesa e Dytë

Selatin Novosella: Atë ditë Sabriu shumë në qef, tha, "A i keni ni lajmet?" Thashë, "Jo". "Pse?" Thashë, "Me ni tren kemi ardhë Fushë-Kosovë - Beograd e kemi ndrru. Prej Beogradit në vend tjetër, Zagreb.

Zagreb kemi hipë në Rijekë prej Rjeke në... nuk dijmë kurgjo hiç që tri ditë jemi në udhë”, tha, “E kanë rrethue Aleksandër Rankoviçin”. Ai Rankoviç i ish shoku ma i ngushtë i Marshall Titës. Po vet fakti që ish shka e kish qenë shef i UDB-së për ta kish qenë lajm i mirë edhe doli lajm i mirë. Doli lajm i mirë. Me pasë qenë ma të vjetra [u drejtohet intervistuesëve] kishim folë ma shirë se kto sene ju s’i dini kuptohet. Keni ni diçka po nuk...

Anita Susuri: Po, po, e di...

Selatin Novosella: Jo, unë po them nuk i dini detalet, se ju padyshim që dini shumë. Por të ishit konë ma të vjetra kishit pasë informacione ma shumë, se e di që i dini krejt nga pak. Faktikisht ‘66-ta ka qenë lajm i mirë, shumë i mirë. Filloi në ndërkohë liri nga burgjet. Na që na përjashtunë prej shkollës, na pranunë në studime. Unë fillova në fakultet, domethonë kisha hupë... isha në gjeneratë me Ibrahim Rugovën, e Sabri Hamitin e me shumë të tjerë, por kisha mbetë mrapa se dy-tri vjet çoban.

E tash, viti ‘66 deri në ‘68 ke ni kohë, nifare lloj romantizmi i llojit të vet. Pse? Se nisi me ardhë shtypi prej Shqipnisë, ilegalisht. Nisën me ardhë librat prej Shqipnisë, “Historia e Skënderbeut”, “Trim i mirë me shokë shumë”, prej Pitarkës, fotografitë e Skënderbeut, emblemat e Skënderbeut. Ishte viti i 500 vjetorit të lindjes. Kangtë për Skënderbeun, filmi për Skënderbeun. Ka qenë ni Kino Armata ktu dikund. Ka flejt, kanë flejt për me mujt me ble bileta në saba për me shku me pa filmin Skënderbeu, ish kohë romantizmash.

Anita Susuri: A e keni pa edhe ju?

Selatin Novosella: Po, qysh jo.

Anita Susuri: Qysh ka qenë? Çfarë ndjenje?

Selatin Novosella: Tash osht’ ai, hin në Google kqyre Skënderbeu, rolin kryesor e lun ni rus. Osht’ filmi ma i mirë që osht’ shkru, që osht’ xhirue deri tash. Pse? E ka bo produksioni ruso-shqiptarë. Kur e pajshim na luftën e Skënderbeut, heroizmin e tij, domethonë... mandej fillunë me ardhë dramën, “Cuca e aleve”, “Shtatë shaljanët”, “Trim i mirë me shokë shumë” e tjera. “Plaku i maleve”, për Bajram Currin. Faktikisht te na filloi ni lloj reaktivizimi, jo veç neve në ‘64-tës se kish pasë edhe ma herët, faktikisht nisi m’u kriju optimizmi që po bohet mirë.

Në ndërkohë, mas rrëzimit të Rankoviçit, tash Tito ishte ni strateg i njohur, ishte ni patriot i madh, shumë i madh jugosllav si kroat që ishte. Bile, ka pasë thanë niherë [Kaqusha Jashari](#), fola unë diçka në këtë kontekst për Titon. Tha, “Unë jam Titiste. Por, ty me të ndi dikush që je ka flet për Titon fjalë të mira”, thashë, “Titoja ma së pari nuk ishte as shka as cërrnagor, Tito ishte kroat dhe ishte patriot i madh. Jo serb as kroat, jugosllav, e don Jugosllavinë shumë”. Jugosllavia ka qenë shteti ma stabil, ma i fortë, ma demokrat, ma ekonomikisht i fortë se krejt shtetet e lindjes. Tash mujnë me thonë, “Qysh po

thu? Tri herë je konë i burgosun në kohën e Titos?” Unë p’e thom të vërtetën historike. Kjo është e vërteta historike.

Titoja e shfrytëzonte, herë vinte Kenedi në Beograd herë vinte Krushqovi², domethonë ni gjeni, ni strateg që ka ditë me i shfrytëzu konjunkturat si rrallë kush deri tani. Bile nashta askush. Kjo është e vërtetë. E tash fillunë diskutimet për ndryshime kushtetare, për me u avancu statusi i Kosovës, m’u bo Republikë, m’u fitu e drejta e vetëvendosjes, m’u hap Universiteti i Prishtinës, m’u leju literatura prej Shqipnisë. Nisi me marrë frymë. U mbajt konferencë ndërkombëtare, jo kombëtare, ndërkombëtare në sallën e Kuvendit të Kosovës.

Aleks Vuthaj ishte kryetari akademik i shkencave, e kishin pru bustin e Skënderbeut dhe e zbuloi Fadil Hoxha, busti i Skënderbeut në sallën solemne të kuvendit. Kenë me francezë, e rusë, turq e me italianë. Dikun rreth 80 kumtesa janë lexu. U lexu, ti deri dje ta ka marrë fotografinë ta ka qkye “*Gde se rodio Skenderbeg?*” [srb.: Ku u lind Skenderbeu?] e tash, u bo ndrrim shumë i madh. Kto sene duhet të vlerësohen në mënyrë kritike. Vetëm xhahilat, e xhahilat turqisht, arabisht i bjen pa shkollë, pa dije, pa edukatë rrejnë. Nuk bon me rrejt, duhet me thanë të vërtetën. U bo ndrrim i madh. Veç Adem Demaçi edhe plot shokë të tij mbajshin dënime të randa hala.

Tashti na lindi ideja me bo demonstrata. Se shkijet thojshin, “Republikën e Kosovës po e dojnë veç do nacionalista, do irredentista, do enversita”, e m’u bo me dije që jo po e lypin edhe studentat edhe populli, na dulëm në demonstrata. Që dishin çka janë demonstratat, s’kishim pa kurrë, e kqyrshim në televizion qysh i bojshin në Paris, qysh i bojshin në Berlin, qysh i bojshin në Amerikë, qysh boheshin në Londër, me pa teknikisht qysh boheshin. Na kujtojshim, si të dalim na vrasin krejt. Bile njo prej atyne shokve tonë të organizimit po thotë, “Nëse na plagosin ose na vrasin çka me ba?” Ndjesë pastë, ni Osman Dumoshi, “Me të qit’ në trotuarë e me vazhdu demonstratën. Ka kohë me u marrë me ta”. Se të rijtë, shqip i thojnë: “I riu si veriu”, ata qaq si të budallaft ata s’tuten hiç.

Demonstrata dul shumë e fortë, shumë. Pa marrë parasysh që u vra ni djalë, në durë të mija u vra ai djalë, Murat Mehmeti, jena plagu diku rreth dymdhetë me armë zjarri, me dhjetra janë lëndu, janë dënu edhe 70 e sa se u bonën... demonstratat e para kanë ndodhë, është mirë me ditë ju në Prizren, pikërisht në Prizren. Mandej, në Pejë, Prishtinë e tjera e tjera. Demonstrata dul e suksesshme shumë. Na u gjykum mandej e plot të tjerë. Unë u dënova me nantë shokë të mi. Unë u dënova pesë vjet edhe kështu.

Anita Susuri: E qysh ka qenë organizimi? A është... sigurisht është bo ni lloj organizimi për atë lloj demonstrate?

² Nikita Hrushçovi (u lind në Kalinovk më 17 prill 1894, vdiq në Moskë më 11 shtator 1971), ishte një politikan rus, kryetar i BRSS. Pas vdekjes së Stalinit ka qenë kryetar i partisë.

Selatin Novosella: Me folë për organizimin duhet me folë dy orë. Po nëse vllau s'ka guxu me ditë nëse po organizohet, nëse nana s'ka ditë që po organizohet, se na tubimet i kena majtë nëpër shpija. Për shembull, kur kanë qenë te unë te shpija, kanë qit' ni krelanë e kanë qit' pak djathë, ka pru ni kup çaj janë ardhë po rrijnë shoktë. Kur ka hi anëtari i familjes mrena s'e kanë ditë që jena në mledhje, s'e ka ditë Sabriu që në ndërkohë ka dalë prej burgut, ai s'e ka ditë s'ka guxoftë me ditë. Nana Naile nuk ka guxoftë me ditë. "Po rrin shoktë po bojnë llaf e muhabete".

Aty kena caktu çka kemi me kërkue, kush ka me shkruë, kush ka me ngritë parolla, kush ka me ngritë demonstratat, kush ka me marrë lidhjen me qytetet tjera. Domethonë është histori në veti. Unë deri tash kam shkru gjashtë libra, domethonë boheshin në ilegalitet të fortë. Edhe demonstratat dulen të forta mandej u bartën edhe në Podujevë, në Gjilan e në Ferizaj. Dolën të suksesshme, aty kërkesa kryesore ka qenë vetëvendosje, që është shumë ma shumë se republikë. Po kuptohet edhe Republika e Kosovës.

Fillun masandej me marrë dënime, na shpërndajtën në krejt Jugosllavinë dhe... faktikisht është ni element familjar, unë isha fejue dikund tre muj para se të burgosem dhe kuptohet kjo është nusja ime {tregon me dorë kah fotografia} dhe ka prit kuptohet katër vjet. Unë bile ia kisha shkru ni letër masi u gjykova... në ndërkohë do të botoj se vitin e ardhshëm e bën 50 vjetorin e lindjes i kom nda të gjitha letrat që ia kom çue edhe të gjitha që m'i ka çu në burg dhe do ta botoj ni libër, letrat. Qysh i kom nxjerrë prej burgut e di unë.

Në atë letër i them dikun, nuk po i them, bile edhe libër e kom shkru. Shoktë e mi kanë thonë pse s'i ke thonë, "E dashur", s'i kom thonë e dashur. Kom dashtë me e bo ma të largët, kom dashtë me lirue nga obligimet ndaj meje. I kom thonë, "E nderuara vajzë", jo e dashur, "E nderuara vajzë, unë jam gjykue pesë vjet burg të randë", nuk u dashtë me thanë po qe e kom thanë, "une sa vjet i maj", i kom thanë diçka që s'u dashtë m'i thanë, me lëndue, "po a dal nga burgu a jo, nuk dihet. Ti kurrfarë obligimi për mue nuk ki, ti je e re, martohu, formo familje kqyre jetën tane. Kurrfarë obligimi s'ki për mu hiç". A kom mendu qashtu? S'osht' e vërtetë (qeshë). Po dojsha që thojnë me konë në paqe me veten e me Zotin. "Nëse unë jom përcaktu për këtë punë, ti s'ki obligim".

Ajo më shkrun, më thotë, "Jo që pesë, por me u dënu 15 vjet se unë fat tjetër nuk lypi. Kam me të prit tanë jetën, edhe kto kto kto..." Ky fenomen, ju u dashtë me marrë qit' temë jo kta, fenomeni i pritjes, fenomen në përmasa botërore. Jo veç gratë me fëmi, jo veç gratë pa fëmi, jo veç të fejumet, të dashurat sa kanë pritë? Pesë, dhetë, 15. Ali Lajçi 15 vjet dikund s'ka pasë hiç, s'ka pasë kurorë 15 vjet. Shoktë e mi, gratë e tyre nëpër Stara Gradishka janë shku janë fejue, çika të shkollume, të punësime nëpër banka në Prishtinë dhe atje janë shku me u bo kurorë me i pritë. Ky është fenomen të cilit ne shumë pak i kemi përkushtue. Kur po thom na, na, ju, shkenca, dija. Osht' fenomeni i pritjes i grave, osht' mrekulli.

E tash mas lirimit tim nga burgu kuptohet... jom liru me 27, me 27 janar, '69 jom burgosë me 27 janar '72 jom domethonë liru. Mas ni jave jom martu edhe ka qenë ni dasmë e veçantë. Me ni shpi bohej darka... darkat mbaheshin nëpër shpija atëherë. Kur nijshim që në Turqi po mbahen në sallona thojshim çka osht' ajo, si shkijet, qashtu thojshim. Në ni shpi ka qenë nusja, gratë e çikat, në ni shpi kanë qenë burrat, mixhallartë e ku e di unë, në ni shpi kanë qenë shoktë e mi. Dhe u bo ni dasmë, u konë për kohën fenomenal. Bile ish Ansambli Shota, jo këngëtar po muzika domethonë edhe ishte ni moment shumë shumë i njohur.

Bile, nana Naile sa isha une në burg e kish pasë kushtue ni vjerrshë nuses time kurse tri motrat e mia, [Igballja](#), Magbulja edhe Meleqja tri gra të mrekullueshme. Atëherë trijat kanë qenë nxanëse... ajo e ka shkru tekstin, e ka thanë se analfabete u kanë po në mënyrën e vet. Shoqja ime e ka emrin Elife dhe thotë dikund, "Oj Elife he shyhret e ki prit burrin qe pesë vjet (qan), qe pesë vjet oj Elife he shyhret e ke prit burrin qe pesë vjet. Qe pesë vjet që po rrin në robni për me bo Kosovën Shqipni" (qan).

Anita Susuri: Për me i thanë Kosovës Shqipni, me siguri është?

Selatin Novosella: "Për me bo Kosovën Shqipni". E tri motrat e mia me tre defa, qysh knon veç motra për vlla. Ish ni moment që nuk përsëritet. E tash, e tash në ndërkohë mu më lindë djali dhe më lindë me 28 Nëntor. Qysh me ia lonë emrin? Flamur. Po s'mujsha me ia lonë Flamur, se vllau i madh ia kish lonë Flamur. Unë ia lash Valon. Në ndërkohë kur i lindi vllaut tjetër vajza na Flamurin e kishim, tash Valoni ishte djali im, tash vajza e Sabriut që është në Suedi, Vlora. Tash u kombinunë, Flamuri Valon në Vlorë. Çka po du me thonë me këtë? Jo veç na të mirremi vesh. Po ni numër i madh i veprimtarëve politik edhe me emërtime kanë dëshmu përkushtimin, kanë dëshmu përcaktimin e tyre. S'ka rastësi në jetë kurgjo hiç.

Në ndërkohë unë fillova studimet. Në ndërkohë kisha fillu në '68-ën, po ato vite kisha disa probleme të theksime. Në punë s'më lejshin me punue si arsimtar. Tash kisha fëminë. Në ndërkohë më lindi edhe vajza, Donika. Edhe thjeshtë, përsëri kish ardhë ky brezi i Kadri Zekës edhe i Isuf Gërvallës edhe Ilmi Ramadanit edhe shumë shokëve tjerë. E tash vazhdojshin aktivitetet, tash fillon ni proces politik i cili është histori në veti. Se procesi politik dhe procesi i montum politik ka dallim esencial. Procesi politik është ai që dënohet për ni punë që ke bo, kurse procesi i montum politik është ai që dënohet për diçka që mund ta bësh. Ma i tmerrshëm se krejt.

Tash përsëri unë u përfshiva në këtë gjykim, kemi qenë 19 vet. Kuptohet Adem Demaçi është dënu me 15 vjet, Rexhep Mala, Isa Kastrati janë dëshmorë, plot prej tyne janë dënu ka dhetë-dymbëdhjetë vjet. Unë jam dënu shtatë vjet. Tash fillon kjo koha e pritjes të shoqes time, jo shtatë vjet, pesë vjet i kom majt. Që kur kom dalë nga burgu Valoni kish pasë fillue, do të thotë, vitin e parë domethonë të shkollës fillore. Ishte ni moment pak i ndishëm. Që do të thotë, tash gjykimi i tretë për mue edhe filloi burgu i tretë. Burgjet zakonisht na kanë ndrru. Unë për këto katër burgjet e mija thom kom qenë, s'kom qenë

po m'kanë marrë në Burgun e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit ni vit e diçka, Gjilanit, të Nishit, Polarevcit dhe të Beogradit. Po në këto burgje kom majtë dënimin.

Anita Susuri: E pse ka ndodhë ky ndrimi i burgjeve?

Selatin Novosella: Punë policore. Punë e gatë është pse. Për shembull, bojmë grevë. Çfarë greve? S'e marrim bukën. Çfarë greve? S'punojmë. Tash për mos me u çu krejt burgu që i ka minimum një mijë, 1500 tash ata që janë pak ma belaxhi, pak ma kryengritës i çojnë prej ni burgu në burgun tjetër, i transferojnë. Edhe kuptohet edhe i çojnë në qeli, i çojnë në vetmi. Unë nëpër ato vitet e mija, rreth dhetë vjet që kom qenë mu m'kanë majtë dikund rreth dy vjet e gjysë në vetmi. Kurse Adem Demaçin, unë kom hulumtu shumë për jetën dhe veprën e tij, e kisha llogaritë se ka qenë dikund rreth gjashtë vjet e katër muj.

Po tash e dëgjova në ni intervistë Adem Demaçin në ni televizion tha, "Në qeli vetëm kam qenë, kryesisht në dhe pesë vjet e gjysë". E kush më ra në mend? Big Brother. Çfarë gjynahash janë ata? Çfarë fakirash janë ata? Çfarë kërkushi janë ata? S'e ka pa nanën ni javë, kanë. S'e ka pa grunë ni javë, kanë. S'e ka pa çikën... kërkusha bre, gjynaha. Pesë vjet e gjysë Adem Demaçi vetëm, kuptohet me Zotin. Kryesisht në... dhe s'u bo kijameti...

Anita Susuri: E çka ka qenë dallimi ndërmjet ktyne burgjeve? Burgjet a kanë qenë dallim të kushteve a çka ka qenë?

Selatin Novosella: Na kena pasë ni pyetje banale, po thom banale se u konë pa kuptim. Kur i transferojsh prej ni burgut në burgun tjetër, "Cili burg ma i mirë? Në Pozharevë a në Stanishtë?" Pytja duhet me u bo ndryshe, "Cili burg ma i keq?", "Cili burg ma i mirë?" (qeshë). Të gjitha burgjet janë njisoj, kaq.

Anita Susuri: A keni pasë kontakt me familjen në atë kohë?

Selatin Novosella: Po, qysh jo. Rregullisht. Vetëm nëpër burgje hetuese nuk ka pasë të rregullta, për shembull, me muj nuk kom pasë. Kurse kur të çojnë në Pozharevc ose Nish atyne ju thojnë llogore. Atje ki të caktume, ki niherë në mujt 30 minuta vizitë, kaq. E fejumja s'ka mujtë me ardhë se s'ka pasë dëshmi që je i fejum, i martum? Katër vjet kuptohet s'kom mujtë me pa, u konë rregull. Ni letër në mujt, njanën faqe edhe kaq.

Domethonë kushtet... se ata që janë nëpër burgje tjertë nuk i kuptojnë, osht' normal, normal osht' ku mujnë me i kuptu? Po kushtet e burgjeve... e ka jep Adem Demaçi ni intervistë masi ka dalë prej burgut të tretë. Ni shka i Beogradit e pytë, "A po na përshkruan qysh osht' ni ditë e burgut? Veç ni ditë?" Adem Demaçi e ka ditë turqishten shumë mirë, qashtu osht' edhe në gazetë. Thotë, "*Kako bi rekli Turci gjyr da*

gör” [srb.: Siç thonë turqit shiko dhe kupton] “*Anladin mi?*” [trq.: A e kuptove - I drejtohet bashkëbisedueses].

Anita Susuri: *Mhm* [pohon].

Selatin Novosella: “Burgu nuk shpjegohet, burgu nuk komentohet, burgu nuk analizohet, burgu përjetohet”. Nëse e thonë të vërtetën. Jo ma ka bo kështu, po le ato. Ka ardhë, për shembull, veshi i thiut kaq {shpjegon madhësinë me duar} me plot lesh, e zdral e flliqni. Do lakna që ishin kalbë e ishin qitë, e ta ka qitë. Ti ki me hangër, mbijetesa. E qit veshin e thiut e qet’ në bërlllog. I lanë ato lakna ia qet’ pak krypë edhe do vaj nëse e ki. Ose t’i qet’ thojtë e thiut në pasul edhe ti prapë i hjekë thundrat e thiut e hanë qata. Burgu nuk shpjegohet. Nuk shpjegohet burgu. Unë s’kam për qëllim për të trishtu.

Ken kto çikat e ministrisë ni ditë, thashë, “Oj çika, mos kallxoni prralla Burgun e Prishtinës duhet me kthy në gjendje qysh ka qenë përpara. Duhet me i hjekë kto halete. Na nevojën e kena kry në çyp”. Oturak ka pasë, ju s’i mani mend, moti janë konë. Oturak, t’pastërt e me pllantikë është e gërrditshme. Po kur çohet burri s’di, kryn nevojën. Sot s’ka kafshë, në kopsht zoologjik nuk i trajtojnë kafshët, bishat, egersirat qysh na ka trajtu neve Serbia. M’u çu ti publikisht me kry nevojën. Pse e ka bo atë? Për me të poshtëru, me ta hupë dinjitetin, me ta hupë personalitetin.

Prandaj, trajtimi i të burgosurve, thekso shqiptarë, ka qenë i paimagjinueshëm. Ose me t’majtë, për shembull, unë në Burg të Prizrenit kom qenë 14 muj vetëm. Kom lypë, vet kom lypë, vet kom lypë. Jom shku te drejtori i burgut, thashë, “Krejt duhanxhi”. Njani Bozhur [pijke] ish ni shka i Beogradit e pike nifar Zodjaku kaq i gatë {shpjegon me duar gjatësinë}. Njani pike cigare, ia bishin me kutia të kmishave. Tre vet t’u pi duhon. Dritarja ishte sa fotografia e Adem Demaçit, mos te ndyj fotografinë, ma e vogël. U duke me ra qershor, korrik, gusht me ra barka me shti hunën n’mes nja pesë milimetrave mes derës edhe podit për me mujtë me marrë pak oksigjen me hi. Faktikisht të helmojshin. S’po flas për komtë e pa lame, zdrali edhe pislëku që bohet aty.

Shkova te drejtori i burgut në vitin ‘78 thashë, “Drejtor”, thashë, “unë ma në qeli nuk kthehna”, tha, “Përhajër koftë!” Thashë, “Hajër paq! Ti me më çu mu me ni qeli vetëm”. “Po, pse more? Ti je shumë i urtë”, tha, “me gardianë s’po bon problem, me mu si drejtor s’po bon problem, me të burgosurit s’po bon problem”, tha, “duhet me shkru diçka. Unë është e vërtetë që momentalisht jom shefi yt po edhe unë i kom do shefa. Duhet me ditë, me arsyetu pse ti në qeli”, “Ti thuju s’po munët me nejt prej timit, s’po mundet prej zdralit, s’po munët me nejt prej pislëkut”. “Po nuk mujna me të çu në qeli ty”. Thashë, “Që s’më çon të del punë”. “E çka bon?” Thashë, “Boj grevë urie”. “Sa ditë s’e merr bukën?” “S’e marrë”, thashë, “sa t’du. Tri ditë, ni javë, ni muj hiç s’e marrë. Të del punë me më çu nëpër spitale, infuzione, telashe. Ti ki me lejue”.

Se për burgje hetuese janë dy vizita gjatë muajit, “Kur vjen familja”, thashë, “une nuk dal në vizitë e ti ki m’i pru në qeli e s’ta lejon ligji me i pru ose ki me kallxu që jom i smutë në cilin spital ose që jom i

vdekun me ia dhonë kufomën. Tash na del punë”, tha, “Te bojmë ni marrëveshje, ti”, tha, “rri. Unë nuk po të shkruaj letër hiç. Por, kur vijnë me vizitu shefat burgun ju qelin dyrtë ju vesin, ti thuj kom pasë problem me shokë m’kanë prue dje masdite. Kur më vesin mu në zyre pa ty, unë ju them ka pasë ni problem me shokë, s’e kemi bo në raport hala s’e kom dënu në qeli çka ka. A po merremi vesh?” Thashë, “Po”. Aty kom nejt 14 muj. Si Big Brother (qeshë) katastrofë, gjyna kur i shoh.

Anita Susuri: A jeni bo pishmon që keni kërku vet me nejt?

Selatin Novosella: Po, unë kom lyp vet, pse pishmon? Unë kom lexu minimum dhetë-dymbëdhjetë orë në ditë kom lexu aty. Të gjitha gazetate e Kosovës, “Rilindjen”, “Shkëndinë”, “Fjalën”, “Jetën e Re”, “Përparimin”, “Epokën e Re”, tri gazeta prej Beogradit i kom porositë gjithnji: “Politikën, “Borbën”, “Novostin”. E çka ka pasë libër që u botue, nëse më kanë ardhë në vizitë e s’ma kanë pru ni paketë libër ajo ditë për mu u konë... as s’kom kqyrë a ka suxhuk, a ka djathë, a ka kaqkavall, s’më ka interesu. Libra. Prandaj, e ka thonë Albin Kurti ni fjalë të meçme se osht’ djalë i mençur thotë, “Kualiteti i leximit në burg”, thotë, “nuk krahasohet me asni lexim tjetër”. Dhe kjo është e vërtetë. Po që kom kalu mbi 95 përqind të kohës me lexime edhe jom konë rehat. Qysh jom konë rehat e di unë (qeshë). Kështu. Jom liru me 15 qershor domethonë të ‘79-tës edhe përsëri iu kom kthy jetës...

Anita Susuri: E kto gjykimet qysh kanë qenë?

Selatin Novosella: Qysh?

Anita Susuri: A keni pasë avokat, për shembull? Procesi i gjykimit qysh ka qenë?

Selatin Novosella: Avokat unë nuk kom dashtë kurrë. Po sipas ligjit për vepër të randa nuk munësh me dalë në gjygj pa pasë avokat. Ta cakton gjygji edhe e jep ni honorar aty. Po avokati nëpër gjykatat politike, a din çka bon? Merr qat’ honorar shkon prej shpije. Se të burgosurit politikë dënohen para se me dalë në gjygj. I dënon komiteti, policia, UDB-a, veç vesin dëshmitarë, vesin ata, vesin ata kallxojnë prralla, ato s’janë kurgjo hiç. Për shembull, Adem Demaçin kur e kanë dënu herën e tretë me 6 janar, apo shkurt më doket të ‘76-ës është në ligj fjala e fundit. A të dënojnë ni muj, a gjashtë vjet, a të pushkatojnë është fjala e fundit, domethonë qashtu është në terminologji juridike.

E vetën Adem Demaçin, “Çka ki me thanë ti fjalën e fundit?” Tha, “Unë kom me thanë që herën e parë kom punu veç që s’kom ditë ma shumë edhe kom organizu veç që s’kom ditë ma shumë. Qëllimi u konë me u bashku me Shqipninë. Kësi hovi s’kom bo kurgjo hiç, s’pata vakt tash dola prej burgut, para do ditesh”. U konë i Prizrenit ni qen bir qeni, Durmish Kaqinaj ni gjykatës e vet kish pasë thonë, “Nëse bon unë shkoj”, se në Prishtinë nuk kanë dalë në gjykatë atje, “unë shkoj e gjykoj Adem Demaçin”. Edhe kur e kanë gjyku e kanë ngritë në pozitë meniherë.

Shqiptarët që janë konë ma të zi se shkijet në pushtet kanë bo gara për me mujtë me marrë pozita. Kto sene duhet me u thanë, duhet me u theksu. Dhe çka osht' e vërteta, domethonë ishte ni gjykim i tmerrshëm. Na jena konë 19 të burgosur, kena pasë 19 policë dhe i kena pasë 19 anëtarë të familjes. Secili në pranga jena konë të lidhun mbi policin. Nuk ke guxoftë me kqyrë as shmajt as djatht. Ata që kanë pi duhon nuk kanë guxoftë, që s'ka shkrebëz me ia lypë shokut, polici ia ka dhezë.

Kurse në fjalën e fundit të Adem Demaçit, tha, "Qajo çika që po shkrun qatje shkruj. Unë kësi hovi nuk kom bo kurgjo hiç, as Selatinin as Osmanin, dy-tre shokë që po i shoh qitu që më keni qit' me u gjyku bashkë me kta. Edhe me kta s'kom bo kurgjo hiç. Ju po doni me ditë mendimin tem, bindjen tem politike po ju thom. Pa u çliru Kosova dhe viset shqiptare nën pushtimin e Jugosllavisë, nuk ka me pasë paqe në Jugosllavi, në rajon, në Europë. Këtë ta kini parasysh".

Unë s'kom me nejt kësi hovi, se herën e dytë kom nejt rreth katër vjet me Adem Demaçin, e kësi herin e tretë s'kom nejt. Shoktë e kishin vet gjatë burgut, "Pse bac? Çka t'u deshtë ajo fjalë? Mujshe mos me thanë, a pak t'u doke që po gjykoheshe?" "Pasha bacën unë e kom ditë që më dënojnë 15 vjet. E qysh me i pagu une 15 vjet? Edhe e dyta shpirt po bajm, nuk kom mujt me dekë në burg e ata masandej kujtojnë që e kom ndrru mendimin", edhe kështu domethonë. Pastaj mas çlirimit në të '80-ën fillunë demonstratat e '81-tës. Përsëri më kanë burgos pak, por jo si... organizator. Më kanë majtë dy-tre muj nëpër burgje edhe kështu.

Anita Susuri: Deri në cilin vit keni qenë të angazhum ju në këtë lëvizjen? Në kto Lëvizjet Ilegale që kanë qenë?

Selatin Novosella: Ilegale? Të kallxova. Vitin 1964, vitin 1968 dhe ma vonë në organizime ishin do organizime jo shumë të organizume, por prej '64-tës deri kur ka ardhë në thojza demokraci e viteve të '90-a kom qenë tanë kohën në Lëvizjen Ilegale. Pastaj vitet e '90-a vijnë, kohë tjera, rrethana tjera. Tash me ia lypë Republikën e Kosovës nuk shkojshe në burg edhe domethonë, thjeshtë, e drejta e të folurit ish. Unë kom qenë anëtar i Këshillit Qendror të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetar dege të Prishtinës. Vitin 1992 kur janë bo zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale kom qenë deputet i atij kuvendi, domethonë me Rugovën e të tjerët.

Jena mundu me bo gjatë ktyne viteve dhe besoj që ka qenë vitet të mundimshme, të lodhshme, të dhimbshme. Po lëvizjet politike s'kanë qenë kurrë ato që kemi mundu me bo. Gjithmonë kena bo ni lëvizje paqësore, mortore. Paqësore të pritjes, paqësore të ndejtjes, paqësore të heshtjes. S'kemi bo ni lëvizje paqësore aktive. Se autoritetin që e kanë pasë të burgosurit politik dhe Lidhja Demokratike në krye me Rugovën prej të '90-ës deri në '96-ën ti ke mujtë qiellit me ia msy. Qasi autoriteti kena pasë, unë e di.

Në rend të parë Rugova e tjerë, por Rugova e kishte tezën me nejt, me prit, me heshtë. Me dalë prej pune? Me dalë. Me lshu spitalet? Me i lshu. Me i lshu fakultet? Me i mshelë. Me shku fëmijtë te shpija? Me

shku. Ajo ishte ni politike katastrofike. Unë tetë vjet kom qenë bashkë me Ibrahim Rugovën. Ishin vite shumë të tmerrshme. Por me kalimin e kohës u pa që ajo taktikë duhet të ndrrohet, duhet të ndrrohet dhe s’bohet pa u ndrru. Faktikisht atëherë lindën ide që duhet me bo lëvizje paqësore po se po, por lëvizje paqësore aktive të tipit Martin Luther King-ut në Amerikë, të tipit të Gandit [në Indi].

Kjo fjala që u bo lëvizja Gandiste-Rugoviste totalisht s’është e vërtetë hiç. Ktu u bo ni lëvizje qyqare, kurse atje ka qenë ni lëvizje demokratike paqësore. India që ishte koloni e Britanisë të Madhe, çka? Kolonitë janë majtë 99.9 përqind, pa qind përqind për arsye politike. Të gjitha luftërat që bohen sot krejt, krejt edhe lufta e Kosovës u bo për arsye ekonomike. Nëse i mshon barazimit atje. Tash Gandhi me nalle, me ni çarçaf të bardhë, me ni dhi, me tomël të dhisë ni filozof i llojit të vet. Vishin mallrat, sipas historisë, me dhetë anije prej Anglisë artikuj të gatshëm, ushqim, shtroj, mblojë, veshmbathje m’u shitë. Ky veç ju thojke, “Mos i zbrazni anijet e pushtuesve tanë, leni”. Çka? Rrishin ni ditë, ni javë, ni muj prisheshin, ju kalojke afati.

Tash me i marrë landët e para bananet, pambuku, leshin, xehet, mineralet me zor policia angelze me i ngarkue nëpër anije me i çu me i përpunue. “Mos i ngarko”. Je t’u blloku. Demonstrata, qindra policë, mijëra i ndajshin i rreshin, i shkelshin. Ky thojke, “Mos ju ktheni, mos ju ktheni le t’ju rrahin”. Ajo u shndërru në ni lëvizje... faktikisht mbretërinë ma të fortë të kohës sikurse osht’ Amerika, kur i mshoi Amerika... e kom ni te Adem Demaçi mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim, barabartë i dul zero. Na kena mujtë me bo ni lëvizje paqësore aktive në Kosovë. Ndër belaxhi kom qenë edhe unë e Adem Demaçi e Ramë Buja, po nuk na shkoi.

Erdh koha kur u duft me u ndrrue letra. Me ardhë letra e lëvizjes tjetër, u bo lëvizje e armatosur. Me çfarë kushte? Kurrfare. Kurrfare hiç. Me asni shansë për fitim. Po për fatin tonë, për fatin tonë të madh që kto vitet e pritjes që i quan edhe Rexhep Qosja edhe shumë të tjerë e patën ni të mirë. Se kanë thanë, çdo e mirë e ka ni të keqe, por edhe çdo e keqe e ka ni të mirë. Tash u bo që kryengritja, lufta e UÇK-së në Kosovë nuk u bo kur u bo në Kroaci, nuk u bo kur u bo në Slloveni, nuk u bo kur u bo në Bosnje. Edhe ndodhën tri momente në përmasa botërore. Çka mujshin me bo shqiptarët? M’u vra. Po ti nuk vritesh për m’u vra, ti vritesh për me pasë efekt.

Pjesa e Tretë

Selantin Novosella: Në Vukovar. I kom pa. Në spital kanë hije shkijet në Vukovar i kanë pushkatu të gjithë. Ia kanë hjekë infuzionin se pa... nëpër spitale kroatët i kanë mytë, e kanë zhbërë Vukovarin, krejt e kanë fshi para syve të botës. Çka ndodhi? Ndodhi Sarajeva. Me muj shkijet e kanë bombardu Sarajevën pse është kryesisht qytet musliman. Në filmet ndërkombëtare e kom pa, fëmi e ka marrë tri copa të parketit në banesë i shtini në koftorr. E ka rre nana, “Pse tri copa të parketit? Veç njo shtine”, me mbijetue. U bombardunë, u masakrunë dhe Evropa qato i pajke.

E treta dhe kulmi ishte Srebrenica. As burrë, as gru, as plak, as plakë, as fëmi krejt të ri, krejt djel. Për arsye të Evropës u masakrunë. E tash pas Vukovarit, Sarajevës e Srebrenicës, kupa u mush. E nëse ka pasë, mos të hi në politikë se s'ka lezet të hyj në politikë, nëse ka pasë mision, nëse ka pasë efekt pozitiv ka pasë pikërisht mendimi, qëndrimi i Rugovës se ktu nuk ka luftë, nuk ka masakër, na mysin krejtve. Dhe e kom pasë koleg e profesor edhe kom pasë shumë relacion po s'jom pajtu kurrë absolutisht me të. Si njeri shumë i kulturum, shumë i ditun, por në aspektin politik gjyna.

Kto kur ndodhën kto tri sene atje tash e shpallën pavarësinë edhe Kroacia edhe Sllovenia edhe krejt, në atë kohë kom qenë përfaqësues i ni firme të njohur të Sllovenisë të Skofja Llokës. Herën e fundit kur kom udhëtu kom udhëtu mes aeroporteve tonë Shkup-Zagreb. Në Zagreb e morëm *rent-a-car* [me qera] ni veturë, se u mshelën kufijtë. U bombardu Berniku i Ljubljanës. Ata bonën rezistencë paqësore, dulen ushtria, shkije kuptohet. Ata kur dolën prej kazermave, se ushtria ka komandu shkijet. Tash sllovenët si popull i njohur politik, çka boni? Ju nalën rrymën, ju nalën ujin, ju nalën ushqimin, ju nalën furnizimin.

Prandaj, lëvizjet paqësore ka pasë qit' efekt që t'ish nisë ma herët ka qenë shumë rrezik. Dhe erdhi lufta. Unë gjatë luftës kom qenë kryetar i Këshillit të Emergjencës që ka qenë ni sektor shumë i randësishëm i logjistikës, por edhe për strehimin e atyne që ju kalleshin shpijat e digjeshin edhe fëmitë jetima që mbeteshin me gra me krejt. Po, sidomos për furnizimin e luftës me përjashtim të armatimit kuptohet. Shtrohet mbulojë, ushqim, veshmbathje, ilaqe, derivate, vetura, domethonë unë kom shkru libër për atë ngjarje. Edhe erdhi liria.

Anita Susuri: A keni qenë ktu gjatë luftës në Prishtinë?

Selantin Novosella: Qysh?

Anita Susuri: A keni qenë në Prishtinë gjatë luftës?

Selantin Novosella: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për juve?

Selantin Novosella: Ç'është e vërteta, ni kohë kom qenë në luftë ktu, gjatë luftës nuk po flasim se tregova që po, ni kohë thjeshtë erdhën paramilitarët me maska edhe na qitën jashtë. Çdo përpjekje me ikë me u skajue veç majshe me marrë bo ni punë, m'u pushkatu publikisht se ishin me maska. Ish gruja me fëmi me familje. Faktikisht ni kohë kom qenë edhe në Maqedoni edhe kështu. Mandej prej Maqedonisë ni kohë kom qenë në Shqipni por me punë. Kurse kur kom qenë në Maqedoni i strehum, e kom ardhë po më duket u konë meniherë mas bombardimeve, ditën e tretë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë ai kthimi? Çfarë ndjenje po edhe çka keni pa gjatë rrugës kur jeni kthi? Qysh ka qenë Kosova? Në çfarë gjendje?

Selantin Novosella: Po me thanë në mënyrë telegrafike ka qenë kjo, po bahej ndrimi i shekullit. Në kufi ka qenë rampa e UÇK-së, ushtarë të UÇK-së e kishin qit' rampen mandej ishin ushtarët anglezë dhe kufi kuptohet nuk kish. Njësitë elite tokësore hala vazhdojshin prej Maqedonisë me hi për Kosovë. Në aspektin njerëzor, etik, moral ka dhimbje. Unë e pashë ni kasaphane. U nguta me hjekë ka i prejnë vjetat dikund nuk mujta me pa, se u tmerrova domethonë, se me i pa shkijet qysh i kom pa.

Veç shkijet e pagujshin targon njiqind vjeçare na ishim nëpër autobusa në mënyrë të organizume. Na ishim me vetura, kuptohet unë s'isha se veturat m'i kishin marrë e krejt, por me randësi ishte në Prishtinë, ishim në Kosovë. Me dritare të çelme, me flamur kombëtar, me flamur amerikan, me kangë, me brohoritje, me... kurse a din çka bojshin shkijet? Tash, na para se me kanë turq, para se me kanë shqiptarë, para se me kanë bugarë, na jemi njerëz. E njerëzorja është më shumë se kombëtarja. Ti munësh me konë turke shumë e mirë, ti s'je kërkushi nëse nuk je njeri i mirë. Njeri duhet me konë ma s'pari, insan. Tjerat udha e marë, çfarë feje, çfarë kombësie. Mu m'ka ardhë gjyna.

Autobusat, kamionat, traktorat me shkina, me shkije të vogël t'u kajtë, t'u trishtu, t'u ia mshelë nana fëmive sytë... se rruga prej Veternikut në drejtim tash me ia drejtu kah Serbia kanë ikë anej, na hishim faktikisht me Amerikën dhe NATO-në përmi në qiell. Elita për tokë, na hishim me çka? Me kerre, me autobusa. Hishim në Kosovë në Prishtinën e lirë, ata ikshin, ikshin, ikshin. Të trishtum, sytë e atyne fëmive s'i harroj kurrë të trishtueshëm. Pse? Se e kanë ditë çka kanë bo në Kosovë.

Për herë t'parë që ju ka tregu baba edhe gjyshi e të tjerët, për herë të parë kanë bo shkijet kësi hovi, kurrë s'kanë bo. As në Luftën e Parë Botërore, as në Luftën e Dytë Botërore kurrë s'kanë bo ashtu. E kanë pshtu njani-tjetrin, e kanë pshtu. I kanë vesh në çarçaf shkijet me pshtu. Kësi hovi kojshia kojshinë e preu, kojshia kojshisë ia kallë shpinë. Shpinë time tre-katëshe ku e kam te Dodona kish qenë stacion i policisë edhe shtëpi publike. Kush e kanë bo? Shkijet e mahallës. Bile kur u kthym atë ditë se edhe stacion policie munësh me marrë me mend çka ka ndodhë. Bile kishin pasë thanë me kallë shpijen e fundit, por për fat s'e kishin kallë.

Njësitë angleze qysh kanë hi ata s'i mani mend ju [i drejtohet intervistuesës] tre policë përpara, tre ushtarë, jo policë, ushtarë tretë me automatikë të veshun kurse tre tjerë shpinë për shpine. Ata ia sigurojshin shpinën ktyne, kta shpinën ktyne. Kta sigurojshin përpara, kta përmas. Ushtri angleze. Miza s'ka mujtë me hi aty në mes tyne. T'u ikë ata. Tash njëri prej ktyne shkijeve, kena pasë të njofshëm, për herë të parë, për herë të parë, unë e kom ditë s'ka folë kurrë shqip. Po i thotë shoqes tem, "Kojshike a erdhët?" Kjo gruja ime, ni gru e mrekullueshme, e urtë, e sjellshme që s'ka pasë rast me folë me shkije e kojshillak, e s'ka pasë nevojë. Ama kur e ka pa çka kanë bo tha, "A erdhët?" Kur m'ka kallxu... çka e kish pasë vet s'ki idenë, "Na erdhëm po ju çka po pritni pse s'po shkoni në Serbi?" Çka m'i thanë ma tepër?

Djalë e ka pasë inxhinier, djalë e ka pasë mjek specialist kirurg. Qiky specialisti gjatë luftës ish shku në uniformë, mjek në uniformë të paramilitarëve. Lagjja jonë për 24 orë as shka, as shki, as fëmi as krejt kanë shku. Unë jam i fshatit Maxhunaj, në krejt katunin tonë, në krejt përveç rrathëve të bunarve që s'kanë mujt me i hjekë se kanë qenë me beton, krejt i kanë kallë rrafsh me tokë i kanë ba. Kur kanë ikë shkijet, tash shqiptartë çka kanë bo? I kanë kallë të shkijeve krejt çka kanë pasë edhe e kisha përfunduar me ni konstantim.

Mixha im, tash i ndjeri Isaku, ka banu në Prishtinë gjatë luftës, si të ikun, katunar. Si ka pa që janë çelë udhtë për katun, "Më kanë mbetë loptë në katun", se familjartë i ka pasë me veti, e tha, "me shku me kqyrë çka kanë bo, a kanë cofë, a i ka thy kush senet". Ka qenë ni moment shumë interesant, politikisht i fortë edhe historikisht, tha, "Kur shkova hypa në autobus për në Vushtrri p'e shoh" tha "paramilitarë, shkije, shkina, fëmi, të pitë, dikush po kanë, dikush po thotë 'Gde ćemo, šta ćemo?'" [srb.: Ku do të shkojmë, çka do të bëjmë?] tha, "u tranova çka pashë aty", gjendje depressive, kah ikin.

Kishin ni kojshi i këtij axhës, paramilitar i veshun, se shkijet në fshatin Maxhuni e kanë ditë shqipen ujë me theksin shqip. Shpijat i kanë pasë ballë për ballë vetëm lumin ndërmjet. Po i thotë, "Isak Maxhuni", po i thotë, "e ke bo ni gabim", tha, "Nashta valla", "u dashtë me pritë edhe nja dy-tri ditë. Po e sheh në autobus Kosova po hallakatet", tha, "na po ikim", tha, "ju", tha "ikët edhe po ktheheni na", tha, "po ikim mos me u kthy kurrë në Kosovë. Pesë lopë tua që i ke pasë në ahër, unë t'i kom marrë loptë tua në ahër tem janë. Shko merri tri-katër lopë të mija që janë merri krejt. Ti ki pesë djel i ki dy shpija, unë kom ni shpi dy katëshe njo tri katëshe, e din. Të kisha thonë, mos i kall". Ndëgjo, ai ka folë në emër të shkijeve të Kosovës, "Unë po dal, nëse kthehna najhere, që s'kthehna kurrë nuk m'i jep. Jo, jo, mos i kall se të vyjnë për djel tu, se na", tha, "e hongrëm se u çumë peshë si popull".

Kjo është një prej konstatimeve ma të mëdha që ka mujtë me thanë ni shka që osht', që thojnë, që osht' *trezan* [srb.: i kthjelltë] që osht' kthjellë. Ato që kanë bo shkijet në luftën e fundit është pa precendan. E tash mas do ditësh axha po thotë, "Çka me bo bre mixhë? Krejt po i kallin", "Unë të kisha thanë mixh mos u ndani. N'ju marrtë menja me kallë, hiqne krejt fshinë prej tokës", tha, "Loptë i kom marrë të mijat e të atij e traktorin e kena marrë", thashë, "Une kisha propozue mos leni gjurmë". Kur ka hy tash me i kallë, tash pemtë i kanë pre i kanë bo dru. Shkijet në mes veti kanë pasë dy vllazni, ni metër murin me gurë, ni metër me tulla, muret i kanë djegë. Ni metër, dy të rrathve të bunarit sa kanë mujtë gurtë i kanë hjekë e kanë bo shkrefhtë. E sot katuni që ka pasë ma shumë se gjysën shkije, s'e ka asni shka.

Ka me ardhë ni ditë, unë se me shoqen time është ni restaurant pregaditin peshkun qitu të mirë te "[Restoran] Kalifornia", tha, "Qiky katuni pak ma larg", thashë, "qaty osht' Babinmosti", aty shkijet me mujtë me shku prej atyhit, po s'kanë ku me shku. Shka në Kosovë sot nuk rrin asnjë. Pse? Kanë bo të pabamet. Na jena shpërblye, jo shpërblye, në kuptimin e dhuratës e as dekoratës. Po jena shpërblye si rezultat i angazhimeve si komb, si sakrificë. Hajt '81-shi (buzëqesh).

Anita Susuri: Dashta me u kthyer te '81-shi se e përmendët edhe burgosjen në '81. A ka ndodhë për shkak të demonstratave diçka në lidhje me këtë apo si?

Selantin Novosella: Mue?

Anita Susuri: Po.

Selantin Novosella: Unë absolutisht nuk kam bo kurrfarë aktiviteti në vitin '81. As në organizim nuk kom marrë pjesë. Vetëm që është e vërtetë që kom dalë në demonstrata. Bile është ni episodë pak banal. Kish ardhë ni si rikoshe, selam, kish thanë, "Selatin Novosella mos dil se je 24 orë i përcjellun prej UDB-së, e si të shohin në qytet kanë me të burgos". Po kur e pashë çka kish ndodhë, e kish marrë "Ramiz Sadiku", e kish marrë "Trepça", e kish marrë "Obiliqi", puntortë me uniforma, me helmata, kanë qenë do si sakica, si teshlica të punës. Faktikisht nuk kish shka, as shkinë, as policë në qytet. E kishin marrë demonstruesit qatë.

Atë ditë kom thanë, vet me veti kuptohet, do t'isha njeri ma i lumtur në botë po t'kisha vdekë atë ditë prej gëzimit. Kur e kom pa Prishtinën në durë të demonstruesve edhe... ama forcat e policisë e të ushtrisë t'u fillu prej armëve të krahut, te armët automatike, prej tankseve, prej autoblindeve, prej helikopterëve, prej aeroplanëve. Në Konventa Ndërkombëtare ishte e ndalume që aeroplanët ushtarakë me fluturu në naltësi të ultë edhe me ba, po i thojshin, plasjen e membranës së ajrit po plaske membrana kur shpejtësia e aeroplanit ma e shpejtë se shpejtësia e zërit po bojke ni krizëm të paimagjinueshme si eksplozim. Gazi lotsjellës po dihet. E pashë atë gjendje.

Dola në rrugë, po e shoh ndash edhe njëqind, ndash 500 çika e djem e kishin rrethu shpijën e Adem Demaçit. Adem Demaçi e majke burgun e tretë. Kta me mijëra vetë, "Adem Demaçi, Adem Demaçi, Adem Demaçi", dhe po ju thom për karshi kuptohet pa folë me kërkond, po a keni pa ju najherë Adem Demaçin? Jo. A keni nejt ju najherë me Adem Demaçin? Jo. A keni vepru ju najçka me Adem Demaçin? Jo. Ata kishin kriju heroin e tyre. Ata i brohoritshin heroit të tyre. Veç demonstratat e '81-shit kush i ka pa, boll ka pa përpara e përmas veç nëse ka ndodhë mrekulli e përmasave botërore ka qenë '81-shi me numrin e pjesëmarrësve, me numrin e demonstruesve. Dhe atë ditë në Prishtinë vriten katër vetë, në Ferizaj vriten dy vetë, në Vushtrri vriten dy vetë, e me qindra të plagosur. Kom shkru libër për demonstratat e '81-shit.

Tash mu në atë natë më burgosin. Çka osht' e vërteta, unë e disha që na burgosin se na kemi pasë nantë burgosje une, vllazërit e mi, nipat e mi kemi pasë nantë burgosje. Dhe çdo herë që u bo diçka po kah dera jonë nuk u bo dikush (qeshë). Unë isha i sigurtë që na burgosin dikë. Dhe, ama qasi rrethoje s'kish ndodhë asniherë. P'e kqyri, e kisha atë shpijen e vjetër po ishin dy katëshe tash është edhe tjetra aty, p'e kqyri për dritare, natën kuptohet, dhe p'e shoh ish bo ni rresht me shpinë prej shpisë krejt me helmata kuptohet, armë automatike. Knej kishin mush oborrin policia.

Unë e kom pasë merak revole me majtë gjithë, gjithë, gjithë. Si student kom pasë revole. E kom pasë vizatue revolën domethonë, qysh është revolja kështu e kisha pre me zhylet. Kom pre, kom pre, kom pre. Qaq shumë kom e kom bo që kur e shisha revolën ktu, nuk u pajke revolja hiç. Kom pasë ni libër të madh, çirilicë “*Izabrana dela Marksa i Engelsa*” [Vepra të përzgjedhura të Marksit dhe Engelsit] edhe çirilicë edhe të Marksit e Engelsit në fakultet e merrsha me veti. Kujna i ka ra në bashçe që në librin e Marksit e Engelsit e kom alltinë e kisha aty. Kom pasë marak. Kurrë s’kom qit’ hiç (qeshë), po kom pasë marak me m’bo shoqni.

Bile në demonstratat e vitit ‘68-ës e kisha me veti ishte kjo artistja, Safete Rogova, ni gru e mrekullueshme e po m’sheh që po du me shti, tha, “O ma se na mysin krejt”, “E çka me bo?” “Ama mu”, “E ti?” Tha, “Po ta mshefi se po të nxunë...” e shtin në çantë të vet. Atëherë studente ishte ajo. Masi kom dalë prej burgut ma ka prue revolën. Po du me thanë, qat’ revole e kisha. Tash, e pashë që isha rrethu. E kisha pa mrekullinë e ‘81-shit edhe m’u kish tekë me gju prej dritarës se kta s’më pajshin. Thashë s’paku nja dy a tre i mys, se s’më pajshin (buzëqeshë).

Po i thom nanës, “Nanë”, thashë, “fundi erdh. Unë nja tre a katër i myti prej naltit”, “O”, tha, “ma djali im se jemi 20 anëtarë të familjes”, e kisha edhe vajzën edhe djalin domethonë, ishin edhe motrat edhe vllaznia, plot. Po unë i kisha teshat e burgut. Ni parë pantolla të trashë, ni xhemper të thurun të trashë. Atje i thojshim teshat e burgut. Në dollap kuptohet gjithmonë i kom pasë edhe i vesha ato. Isha i sigurt që ish përsëndetja e fundit. A prej tutës? Jo. Po qashtu u musha energji kur e pashë qytetin në duar [të studentëve] edhe s’ka kulm ma të madh. Tash kur jom zbritë poshtë po du m’u përsëndetë me anëtarët e familjes, kuptohet fëmijtë ishin në gjumë, Valoni edhe Donika, por ishte shoqja, nana, motrat.

Tash ishte ni horr, ni lbush Kllokoqi që e kurtalisën mas luftës, ia bonën shumë mirë. Më ka pasë thanë çika Donika, ajo është mjeke, “Pse bre babë po thu shumë mirë?” “Po shumë mirë ia kanë bo babë, shumë mirë”, “Po, a e ke bo ti?” “Jo”. Në lajme ka pasë lajmëru Radio Kosova ka lajmëru, Radio Televizioni i Kosovës atë natë që u vra ai, [kishte raportu] tha, “Vllazërit Selatin e Sabri Novosella kanë kthi darkë solemne në Tiranë kur kanë marrë vesh që osht’ vra UDB-ashi lbush Kllokoqi”.

Tash çika meniherë në telefon, “Babë, a është e vërtetë?” “O çika babës rri ti urtë se në Prishtinë jom konë, s’jom konë në Tiranë atë natë hiç. Por shumë mirë ia kanë bo”. “Po, pse mirë?” “Po mirë bre se me vra UDB-ashin osht’ sikur me shkue në lula të xhehnetit”. “Po, a e bon ti?” “Po s’e boj”. Pse? Unë e kisha burgosë, ia kisha nxonë avokatin, koftë i smutë e kisha shëru, i kisha hap hetimet, kisha thirrë dëshmitarë, kisha marrë faktet, kisha marrë dëshmitë e krimeve të tij e kisha gjyku. Unë s’e kisha vra kurrë. Prej natyrës jom i tillë. Amo që e ka vra, shumë mirë ia ka bo, shumë mirë ia ka bo.

E tash, tash derisa po na çojnë neve se kem shumë, ma vonë e kom marrë vesh. Nuk kishim pasë si duket, pranga si lidhësa na lidhën me zinxhirë. E tash për mos me u çkepë, na ngjitën kah ni dry. Natën

po na çojnë dikah. Mu më lidhën me ni Avni Lama, ni profesor i njohur. Kishin, kto kthesat e Badovcit, natën nuk i pajshim veç ma merrke menja. Tash ni rreth ishin anej Njësia Speciale e Serbisë, kurse na ni kamion, me ta marrë menja e ushtrisë. Tash ni prej atyne shokëve “Po dheze”. Kur e dhezë ai cigarën, që unë s’e kom ni këtë dialog, tash tjetri po thotë “*Što si zapalio*” [srb.: Pse e ndeze?]. Tash për me më bind që po na pushkatojnë, isha i bindur. Po i thotë “*Pa neka bre, poslednja želja u životu neka zapali čovek*” [srb.: Dëshira e fundit në jetë le ta ndezë njeriu] (qeshë). Mu më bindi që po na pushkatojnë, ma mirë se drejt s’ka. A u tute? Hiç. Se kta të rijtë edhe budalla janë si njojtë.

Në ndërkohë, pak si në mënyrë diskrete po i thotë njani-tjetrit “*Gde će da bude streljanje?*” [srb.: Ku do të jetë pushkatimi], domethonë, që marrëveshja ku po na pushkatojnë. Atëherë veç erdhi kulmi. Tash unë e kom shqyrtu rastin po i thom këtij profesorit, Avni Lami, i moshum ky. Thashë, “Profesor”, thashë, “unë ia nisa me knu”. “Shuj!” Për besë nën ndikimin e filmave të Shqipnisë (qeshë). Me partizanë, me çetnikë, e me ushtarë e me gjermanë. Unë, më shkoi mendja me knu, por që e disha cilën kangë, për dreq...

Anita Susuri: S’ju bijke në mend.

Selantin Novosella: S’më bike në mend. Kisha qef me knu që me mu bashkangjitë edhe kta. Tha, “Shuj”, tha, “çfarë kange!” Merre me mend kur jena dalë prej burgut po kallxojna rastet, ky qenë njo prej pedagogëve ma të njoftun, po ka pasë edhe ni, ni cilësi ka qenë shumë i bukur, shumë, domethonë, princ. Edhe merre me mend tha, “Hina në tualet, policinë”, tha, “i kisha”, në banesë ka jetu, tash ka vdekë. “Kërsitën në derë s’e çelsha, kërsitën në derë, ‘O po e thejmë derën, çile!’ A din pse s’i lejova?” Thashë, “Jo valla bac, jo”, tha, “M’u lidhën për dreq do kravata s’mujsha me i lidhë mirë”. Merre me mend tash, këto me i kallxu dikush menon që janë të lujtun.

Policia speciale po e marrin me burgosë e me gjyku e nashta me pushkatu ai tha, “M’u lidhën gishtat, kisha qef ni kravatë të mirë me lidh në banjo, qashtu me dalë m’u lidhë në pranga”. Domethonë, këta njerëz nuk kuptohen sa duhet. Jo që po i lavdoj, por ushtarët i kuptojnë vetëm ushtarët deri në fund edhe të burgosurit politik i kuptojnë vetëm... me ta marr mendja edhe artistat, edhe artistat s’i kupton gjithkush. Prandaj, e pata fjalën... prandaj, në ‘81-shin ka ndodhë ni mrekulli, ka ndodhë ajo që ma në histori nuk është përmend ma kurrë.

Pra, që po thom unë dhe shoktë e mi po edhe familjartë e mi edhe sakrificat tona para edhe mas nesh kemi vetëm një ngushëllim, vetëm ni satisfaksion i cili nuk kompenzohet as me lekë, as me pozitë, as me pasuni, as... sot për mue rrethoma qytetin e Prishtinës me murë kinez, komplet rrethoma ami çelsat e qytetit mu nuk më krijon knaqësi, sa më krijon liria e Kosovës. Na të vetmin ngushëllim e kemi lirinë e Kosovës.

Prandaj, kur erdhi kryeministri, kur filloi aplikacioni për kompenzimet ishte kuptohet aq e musha aplikacionin e parë 00001 Adem Demaçaj edhe po i thotë, “Kryeministër”, ishte Hashim Thaçi

kryeministër atëherë, “ndaj të burgosurve politik shteti i Kosovës nuk ka kurrfarë obligimi, na kena kry punën tonë. Ne borxh na ka Serbia”. E tash kryeministri po i thotë, “Baca Adem”, tha, “nuk kena ardhë na me ju kompenzue vujtjet edhe sakrificat e juve, as nuk kompenzohen, as nuk paguhen, as nuk shpaguhen, hiç. Na si qeveri jemi mirënjohës për çka keni bo të gjithë”, tha, “ne me këto 5.5 milion që kemi nda për juve kena dashtë veç të dëshmojmë se ne si institucione të Kosovës jemi mirënjohës, kaq. Mos e merrni si kompenzim, mos e merrni si dëmshpërblim”. E vërteta është kjo.

Prandaj, unë po thom na mujna me nejt rehat të gjithë së bashku. Isha në Ambasadën Amerikane para do ditësh, s’i kom kto bisedat online, s’kom bisedu gati kurrë po ata thanë, “Kena ndalesë”, kishte me ambasadorin diçka. E para se me shku shkova me caktu terminin, po dalin do djel veç Zoti që i kish falë kah ni metër e 90 e sa, të bukur, të shnohtë plus me uniformën e sigurimit amerikan. Me ta kënaqë shpirtin bre. Edhe kur e kanë pa që po du me dalë prej veturës, disiplina amerikane, “Mrena ju lutem, mrena, hiç s’ka me bisedu, mrena”, pse amerikan.

Nuk është hajgare si ktu që e shajnë policinë, kaniherë e kallin, sikur që ia bojke Vetëvendosja! dikur. Ose tash ju mshojnë shuplaka, marrja e Zotit. Pse? S’e dojnë shtetin. Ti mund me kanë polici, mund me kanë, mos fyej. Kur ki uniformë ti je shteti për qata ti ki autoritet, për qita ty duhet me të respektu, me të çmu, me të dashtë. Pse? Përfaqëson shtetin e Kosovës. Dhe kur hina mrena i zbutën fjalte, u rahatum. Ai kish qenë dhandërr i ni shoku tim, Haxhi Zybaq i Prizrenit që e përmenda pare.

Tha, “Unë ju njoh juve... filani, nëpër burgje, ktu, ktu, ktu, ktu”, tha, “Po na”, tha, “tjertë nuk po bojmë sa duhet”. Thashë, “Ju po boni”, thashë, “mrekulli”, tha, “Përhajër koftë”, thashë, “Unë për veti”, thashë, “ma ndreqe ditën. Ma s’pari që t’pashë kaq të bukur, e të pashë kaq elegant, e të pashë në uniformë amerikane”, thashë, “veç që po ju shoh juve para Ambasadës Amerikane”, thashë, “ma ndreqni ditën. Po kur e di”, thashë, “që mrapa, veç asfalti ju ndan, ishte dikur...” A din çfarë gabimi kom bo? A p’e sheh, hiç s’kena pi kafe. Çka po keshë? Pse s’lypshi kafe?

Anita Susuri: S’osht’ problem, kemi pi kafe na (qeshë).

Selatin Novosella: Jo, te unë jo.

Anita Susuri: (qeshë).

Selatin Novosella: Edhe thashë, “Mrapa”, thashë, “e kemi kazermen që dikur u konë Marshall Tita e sot osht’ Adem Jashari”, thashë, “unë dhe shoktë e mi nuk dojmë ma shumë”. Për mu ishte kënaqësi që bisedum.

Anita Susuri: Zotëri Selatin, veç deshta me përmbyll për vitin ‘81 që thatë, qysh përfundoi qato? Nuk ju pushkatun po ku ju dërgun?

Selatin Novosella: A mu personale a? S'osht' me randësi ajo. Më çunë në Burgun e Gjilanit, më majtën ni muj në izolim. Prej atyhit mandej më çunë në Burgun e Mitrovicës më majtën edhe ni muj në izolim edhe erdha te shpija edhe kaq.

Anita Susuri: E a u gzutë që nuk ke pushkatim?

Selatin Novosella: Qysh?

Anita Susuri: A u gzutë që nuk ke pushkatim?

Selatin Novosella: Hiç s'kom mendue. Atë natë e kom thanë, para miqve të mi, s'po muj me ju thanë që ju kom mikesha juve se ju jeni shumë të reja edhe s'njihemi, por po flas sikur para mikeshave me konë. Unë atë natë kom qenë shumë shumë i gatshëm emocionalisht, psiqikisht, shpirtërisht m'u pushkatu. Pse? Çdo njeri e ka ni moment që thojnë. Kur e kom pa ni Prishtinë qysh e kom pa para komitetit, para kuvendit, para policisë, para UDB-së, asni shka veç helikopterat, tanksat nëpër qoshe, aeroplanat nalt, shqiptartë poshtë unë e pashë lirinë me sy. E pashë që kit' popull ti mund me mytë, mund me mytë, mund me burgosë, ama mrapa me u kthy s'kthehen. Ky ka vendosë për lirinë e vet. Demonstratat e '81-shit janë faqja ma e ndritshme që kanë bo shqiptartë ndonjëherë, kuptohet me plot aktivitete tjera. Prandaj, unë dola prej burgut, punova, jetova, gjallnova.

Anita Susuri: Zotëri Selatin, faleminderit shumë për kohën, për intervistën.

Selatin Novosella: Ishte kënaqësi, ishte kënaqësi.

Anita Susuri: Gjithashtu.